



# Aneksi nr. 6

## Statistikat mbi informacionet dhe kërkesat e administruara pranë Komisionerit

Në këtë aneks të raportit paraqiten të dhëna numerike dhe statistikore mbi ecurinë e procesit të inspektimeve, tipologjinë e institucioneve ku janë ngritur pretendime për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil, mënyrën e përfundimit të trajtimit të

informacioneve, si dhe krahasime të numrit të informacioneve dhe kërkesave të administruara pranë Komisionerit gjatë pesëvjeçarit të fundit. Konkretisht, në lidhje me ecurinë e procesit të inspektimeve, gjendja paraqitet më hollësisht, si më poshtë:

### Ecuria e procesit të inspektimeve filluar në vitin 2025

ECURIA	Filluara kryesisht, mbi bazë të informacioneve të nëpunësve	Të filluara me kërkesë të institucioneve	Σ TOTAL
Të përfunduara gjatë vitit 2025	120	14	134
Në proces (mbartur dhe përfunduar, në fillim vitin 2026)	4	1	5
Σ TOTAL	124	15	139

Për vitin e raportimit, nga **139 raste** total të informacioneve/kërkesave të administruara pranë Komisionerit, sipas të dhënave të pasqyruara në tabelën nr. 1, rezulton se, ka përfunduar procesi i inspektimit në **134 raste**, që përbëjnë rreth **96.4%** rasteve të administruara, ndërsa vetëm **5 raste** ose rreth **3.6%** janë të mbartura, për të cilat ka përfunduar trajtimi në fillim të vitit 2026.







Sa i takon ndarjes sipas gjinisë së dërguesit, të numrit të informacioneve/kërkesave të dërguara nga nëpunësit për vitin raportues, të dhënat paraqiten më poshtë. Shifrat në grafikun nr.2 tregojnë një shpërndarje pothuajse të barabartë gjinore në dërgimin e informacioneve/kërkesave, me një diferencë shumë të vogël në favor të femrave

## NDARJA E KËRKUESVE SIPAS GJINISË



Në lidhje me tipologjinë e institucioneve për të cilat kanë ardhur informacionet, paraqitet kjo situatë:

## Tipologjia e institucioneve të inspektuara

  Tipologjia e institucioneve të inspektuara me çështje të përfunduara		  Filluar kryesisht nisur nga kërkesa e nëpunësve/të tretëve	  Filluar me kërkesë të institucioneve	$\Sigma$ TOTAL
A.	<i>Institucione të administratës shtetërore</i>	<u>76</u>	<u>2</u>	<u>78</u>
	Ministri	8	1	9
	Institucione varësie	68	1	69
B.	<i>Institucione të administratës vetëqeverisjes vendore</i>	<u>28</u>	<u>7</u>	<u>35</u>
C.	<i>Institucione të pavarura</i>	<u>19</u>	<u>7</u>	<u>26</u>
	$\Sigma$ TOTAL (A + B + C)	123	16	139

Referuar të dhënave të mësipërme, rezultojnë se nga **139** informacione të regjistruara pranë Komisionerit, **123** prej tyre janë paraqitur nga nëpunës civilë apo palë të interesuara dhe **16** kërkesa kanë ardhur nga institucionet.

Nga **123** informacione të depozituara nga nëpunës civilë apo palë të interesuara, rezultojnë se:

≡ nga administrata shtetërore (ku përfshihen institucionet e administratës qendrore dhe ato të varësisë) janë regjistruar **76** raste ose **62%** e rasteve;

≡ nga administrata vendore (ku përfshihen institucionet bashkitë dhe këshillat e qarkut) janë regjistruar **28** raste ose **23%** e rasteve;

≡ nga organe të pavarura vetëm **19** raste ose **15%** e rasteve.

Nga analiza e të dhënave rezultojnë se, në numrin e përgjithshëm të rasteve të trajtuara që i përkasin administratës shtetërore, peshën më të madhe e zënë kërkesat e ardhura nga institucionet e varësisë. Kjo lidhet me faktin se kjo kategori institucionesh ka qenë në një proces të vazhdueshëm ndryshimi dhe riorganizimi, si dhe ka një objekt veprimtarie më të kufizuar. Këta faktorë

sjellin një dinamikë më të lartë në veprimtarinë e nëpunësve, duke ndikuar si në lëvizjet në pozicionet e punës, ashtu edhe në marrëdhëniet me drejtuesit e tyre, të cilët janë në kontakt më të drejtpërdrejtë me ta për realizimin e detyrave të përditshme.

Gjithashtu, kjo situatë ndikohet edhe nga fakti se në një pjesë të konsiderueshme të këtyre institucioneve mungojnë pozicione të posaçme për menaxhimin e burimeve njerëzore. Si pasojë, administrimi i shërbimit civil kryhet shpesh nga specialistë që, përveç detyrave të tyre funksionale sipas strukturës në fuqi, ngarkohen edhe me përgjegjësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore. Nga ana tjetër, njësitë e burimeve njerëzore në ministrinë e linjës e kanë të vështirë të sigurojnë një administrim të plotë dhe në kohë të shërbimit civil në këto institucione, në përputhje me momentin e kryerjes së veprimeve përkatëse administrative.

Në këto kushte krijohen rrethana që favorizojnë shkelje në administrimin e shërbimit civil ose lindjen e mosmarrëveshjeve, çka shpjegon përqendrimin e rasteve të shqyrtuara në këtë kategori institucionesh.

Sa i përket rasteve të shqyrtuara në pushtetin vendor, mbi bazën e informacioneve të marra nga nëpunësit përkatës, pjesa më e madhe e tyre i përket bashkive. Kjo për faktin se bashkitë kanë numrin më të madh të nëpunësve civilë, të cilët ushtrojnë


veprimtari ekzekutive të përditshme dhe përballen me një dinamikë më të lartë në përmbushjen e detyrave të tyre.

Krahasuar me pesë vitet e fundit, numri i rasteve të shqyrtuara të ndara sipas tipologjisë së institucioneve, paraqitet në tabelën më poshtë:

**Informacionet sipas nivelit të administratës nga kanë ardhur dhe një krahasim me gjendjen e viteve 2021, 2022, 2023, 2024 dhe 2025**

Σ TOTAL	Administrata Shtetërore	Administrata endore	Institucionet e Pavarura
Viti 2021 - <u>118</u> raste	55	40	23
Viti 2022 - <u>94</u> raste	57	30	7
Viti 2023 - <u>120</u> raste	61	46	13
Viti 2024 - <u>145</u> raste	78	48	19
Viti 2025 - <u>139</u> raste	78	35	26

Grafikisht numri i informacioneve të trajtuara gjatë 5- vjeçarit të fundit të veprimtarisë së Komisionerit paraqitet si më poshtë:



Duke iu referuar vlerave të paraqitura në tabelë, konstatohet se prurja e informacioneve dhe kërkesave ka mbetur në të njëjtin nivel gjatë vitit objekt raportimi. Vlerësohet se kjo

situatë, ndër të tjera, ka ardhur si rezultat i rritjes së nivelit të ndërgjegjësimit dhe njohjes nga ana e nëpunësve civilë mbi të drejtat e tyre, të sanksionuara në legjislacionin e shërbimit civil.

Njëkohësisht, roli i Komisionerit në mbikëqyrjen e ligjshmërisë së procedurave të ndjekura nga njësitë e administrimit të burimeve njerëzore në institucionet pjesë e sistemit të shërbimit civil, si dhe nga subjektet e tjera të ngarkuara me detyra specifike sipas ligjit, ka qenë thelbësor. Përmes nxjerrjes së vendimeve paralajmëruese në rastet kur janë konstatuar paligjshmëri në administrimin e shërbimit civil, është ndikuar drejtpërdrejt në forcimin e zbatimit të ligjit.




Kjo qasje ka kontribuar në rritjen e besimit të punonjësve të administratës publike, si dhe të palëve të treta, ndaj institucionit të Komisionerit, fakt i cili dëshmohet nga numri i rasteve të trajtuara gjatë vitit 2025.

Në mënyrë të përmbledhur, përfundimi i trajtimit të informacioneve të ardhura apo të mbledhura nga ana e Komisionerit paraqitet sipas të dhënave të pasqyruara në tabelën më poshtë.

Kjo tabelë reflekton mënyrën e adresimit dhe rezultatin përfundimtar të çdo rasti, duke ofruar një panoramë të qartë mbi vendimmarrjen dhe veprimtarinë e institucionit gjatë periudhës së raportimit.

Mënyra e përfundimit të trajtimit të informacioneve të ardhura apo të mbledhura nga ana e Komisionerit, situata do të paraqitet si në tabelën më poshtë:

### **Mënyra e trajtimit të informacioneve të ardhura gjatë vitit 2025**

 <b>Mënyra e përfundimit të procedurës administrative</b>	 <b>Filluar me kërkesë të institucioneve</b>	 <b>Filluar kryesisht nisur nga informacionet e ardhura gjatë 2025</b>	<b>Σ TOTAL</b>
Vendim për përmirësimin e situatës së paligjshmërisë	0	12	<b>12</b>
Vendim për përfundimin e procedurës për shkaqe të ligjshme dhe arkivimin e çështjes, pasi nuk janë konstatuar shkelje të legjislacionit të shërbimit civil	0	18	<b>18</b>
Bashkuar dhe zgjidhur në procesin e mbikëqyrjes/inspektimit të ushtruar në subjekt	0	12	<b>12</b>
Interpretime / kthim përgjigje kërkuarit në rrugë administrative	12	70	<b>82</b>
Relacion arkivimi/Arkivim pa veprime	2	8	<b>10</b>
Mbartur për vitin 2025	1	4	<b>5</b>
<b>Σ TOTAL</b>	<b>15</b>	<b>124</b>	<b>139</b>

Referuar kësaj pasqyre, Komisioneri ka ndërmarrë si hetime paraprake, ashtu edhe hetime të thelluara administrative, duke trajtuar në mënyrë të gjithanshme çdo informacion të paraqitur pranë

institucionit. Në përfundim të shqyrtimit, ai është shprehur në çdo rast lidhur me shkallën e respektimit të dispozitave të legjislacionit të shërbimit civil, duke evidentuar problematikat e konstatuara

dhe duke orientuar drejt zbatimit korrekt të ligjit.

Në vijim, paraqitet në mënyrë të përmbledhur rezultati i përfundimit të çështjeve të shqyrtuara:

≡ në 12 raste janë konstatuar parregullsi dhe Komisioneri ka dalë me vendim paralajmërues për të rregulluar ligjshmërinë;

≡ në 18 raste është vendosur përfundimi i hetimit administrativ në rastet kur nuk janë evidentuar veprime në kundërshtim me ligjin nga ana e njëjse përgjegjëse apo organeve të tjera të ngarkuara nga ligji me detyra specifike gjatë administrimit të shërbimit civil;


≡ në 10 raste, ka pasur dyshime të arsyeshme për mosrespektim të ligjit, e mbi këtë bazë është urdhëruar inspektimi i çështjes, por gjatë hetimit administrativ nuk janë evidentuar veprime në kundërshtim me ligjin dhe, për këtë

arsye, është vendosur përfundimi i hetimit administrativ dhe është arkivuar çështja, duke njoftuar palët në proces;

≡ në 12 prej informacioneve të ardhura janë bashkuar dhe trajtuar me vendim në kuadër të mbikëqyrjes/inspektimit së institucionit (në ato raste kur grupet e punës, janë ngritur me urdhër të veçantë të Komisionerit);

≡ në 82 raste, për arsye të ekzistencës së kushteve që janë parashikuar në nenet 66, 67, 68, "Çështjet paraprake", të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i RSH" dhe në nenin 16, të Rregullores së Komisionerit, "Mbi Procedurat e Mbikëqyrjes/Inspektimit", i është kthyer përgjigje palëve në rrugë administrative, duke i sqaruar hollësisht për mënyrën dhe organin që duhet të vijojë trajtimin e rastit.



## Mënyra e trajtimit të informacioneve



Duke marrë si referencë tipologjinë e kërkesës/informacionit, nisur nga

subjekti që ka iniciuar informacionin, situata paraqitet në këta tregues:

## Tipologjia e kërkesës/informacionit administruar nga Komisioneri, referuar subjektit dërgues

 Tipologjia e kërkesës/informacionit referuar subjektit dërgues (e përfunduar në 2025)	 Numri i kërkesave
Kërkesë/informacion për mosmarrëveshje administrative të ngritura nga nëpunës të ndryshëm ( <i>personale</i> )	119
Kërkesë/informacion për mosmarrëveshje administrative nga palë të treta	5
Kërkesë nga institucionet apo kryesisht	15
<b>Σ TOTAL</b>	<b>139</b>

Sipas të dhënave të paraqitura, konstatohet se, vendin kryesor në veprimtarinë e institucionit e zënë hetimet administrative, të nisura mbi bazën e indicieve të marra nga informacionet e paraqitura prej nëpunësve civilë apo palëve të interesuara, në **119** raste, të cilët denoncojnë raste konkrete që lidhen me aspekte të ndryshme të zbatimit të ligjit.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nuk ka kompetencë të drejtpërdrejtë për zgjidhjen e ankesave individuale të nëpunësve apo shtetasve. Megjithatë, në ushtrim të së drejtës së tij, të parashikuar në pikën 1, të nenit 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për të ushtruar mbikëqyrje kryesisht ose me kërkesë të institucioneve për zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, çdo informacion apo kërkesë e paraqitur nga nëpunës apo shtetas, për cënim të interesave të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, ka shërbyer si indicie për fillimin kryesisht të një hetimi administrativ dhe për verifikimin e ligjshmërisë së çështjes. Në këtë mënyrë, është ndikuar si në zgjidhjen e problemit të ngritur nga nëpunësi, ashtu edhe në



sqarimin e situatës në rastet kur pretendimet nuk rezultojnë të mbështetura nga pikëpamja e menaxhimit të shërbimit civil.

Nga ana tjetër, nuk kanë munguar rastet kur shtetas apo nëpunës të administratës shtetërore, për motive që nuk ndikojnë në nisjen e procesit të verifikimit, kanë paraqitur denoncime për pretendime të keqmenaxhimit të proceseve administrative të shërbimit civil, me qëllim favorizimin e personave të caktuar pjesëmarrës në këto procese.

Në të gjitha rastet e paraqitura për kërkesa ose denoncime nga persona të tretë, ku është pretenduar se janë kryer veprime me qëllim favorizimi të një nëpunësi ose konkurrenti të caktuar, nuk është vërtetuar asnjë pretendim i tillë. Çështjet përkatëse kanë përfunduar sipas procedurës, ose me arkivim, ose me dhënie përgjigje zyrtare palës denoncuese.

Klasifikimi i informacioneve të verifikuara për vitin 2025, sipas objektit të tyre, duke bërë një klasifikim mbi llojet e mosmarrëveshjeve administrative, të trajtuara kryesisht, rast pas rasti për vitin 2025, gjendja paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

## Mosmarrëveshjet administrative, të klasifikuara sipas objektit të tyre

 Instituti ku pretendohet parregullsia sipas kërkesës/informacionit	 Rastet
Procedurë disiplinore	25
Procedurë transferimi i përkohshëm	7
Procedurë vlerësime pune	16
Procedurë konkurrimi	24
Pezullim nga shërbimi civil	14
Objekti jashtë kompetencës lëndore të Komisionerit	8
Të tjera ( <i>sqarim për kuptim/zbatim të drejtë ligji; parashkrimi i masës disiplinore; transferimi i përhershëm për shkak të ristrukturimit të institucionit; mbi zbatimin e vendimit të gjykatës së formës së prerë dhe të drejtën e nëpunësit për rikthim në shërbimin civil, etj.</i> )	45
<b>Σ TOTAL</b>	<b>139</b>

Nisur nga objekti i çështjeve të shqyrtuara për periudhën e raportimit, rezultojnë se numrin më të madh mes tyre e zënë procedurat disiplinore, konkurrimet, vlerësimi i rezultateve në

punës, transferimet e përkohshme apo pezullimi nga shërbimi civil, etj. Në grafikun e mëposhtëm paraqiten këto të dhëna të shprehura në përqindje.

## Mosmarrëveshjet sipas objektit

